

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 789/4 prot.

Tepelenë, më 04, 05, 2026

V E N D I M

Nr. 36, datë 29.4...2026


**“PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË
BASHKIAKE TEPELENË”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 54 shkronja “ç”, nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, nenit 9, të ligjit nr. 35, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, të ndryshuar si dhe vijim të relacionit të grupit të punës nr.789 prot., datë.23.04.2026,, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Policisë Bashkiake, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar të vitit 2026 dhe do të përballohen nga buxheti i miratuar i Aparatit të Bashkisë për vitin 2026.
3. Vendimi nr. 86, datë 30.11.2023 i ndryshuar me Vendimin nr 55, datë 30.09.2024 , i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë së Tepelenës”, shfuqizohet.
4. Ngarkohen Drejtoria e Ligjore dhe Shërbimet Organizative dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik e Menaxhimit Financiar, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.



Lidhja Nr.1

Niveli i pagave për punonjësit e Policisë Bashkiake

II	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës	Paga bazë	Shtesa për vjetërsi
1	Pika 10	Inspektor i Policisë Bashkiake	64,000	
2	Pika 10	Polic Bashkiak	59,000	

1. Shtesa për vjetërsi në punë për Lidhjen nr. 1 llogaritet mbi shtesën e pozicionit, në masën si vijon:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona Çela

Miratuar me 11 vota

Vota Pro 11

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0 Zbardhur me datë 09.05.2016